



DEVOLLI

Dhe ky plis ngaherë ish i fortë
Shkoi në Evropë, brodhi në Azi,
Por kudo, nga flokët gjer në thonjtë
Mbeti devolli...

D. Agolli

ORGAN I SHOQATËS A. K. "DEVOLLI" Viti XVIII i botimit Nr. 11 (110) Nëntor 2015 Çmimi 30 lekë, 1 Euro, 1 \$ USA

Gëzuar festat e 28 dhe 29 Nëntorit!

103 VJET PAVARËSI! 71 VJET ÇLIRIM!

Nga ERVEHE BARUTI
Kryeredaktore e gazetës

U skuqën përsëri nga flamujt kombëtarë sheshet kryesore të Tiranës, Prishtinës, Vlorës, Tetovës, Ulqinit, Preshevës, Nju Jorkut, Londrës, Brukselit... Në çdo cep të globit ku jetojnë shqiptarë u festua me krenari dhe gëzim Dita e Flamurit. Ndërsa ndjek dhe përjeton mes emocioneve të mëdha jehonën e këtyre festimeve, të krijohet përshtypja sikur Shqipëria nga viti në vit bëhet edhe më e madhe... Ky perceptim shpirtëror dëshmon të vërtetën e madhe se tashmë shqiptarët kanë fituar më shumë dinjitet dhe personalitet. Natyrisht, kriza ekonomike botërore më shumë se kudo ndjehet në Shqipëri, por si në çdo fund nëntori edhe këtë vit të gjithë ndjehemi më të lumtur dhe më të pasur se në çdo ditë tjetër kalendarike. Sepse pa pavarësinë politike dhe identitetin kombëtar nuk do të ndjehesh mirë asnjë qytetar. Ndërkohë si për të shtuar akoma më shumë shenjtërinë dhe bekimin e tyre, Dita e Flamurit ka shumë pranë edhe Ditën e Çlirimit që simbolizon largimin e pushtuesve të huaj nga trualli ynë. Mirënjohja e pakufishme e Kombit në këto ditë të shënuara shkon për të gjithë ata që nuk kursyen jetën e tyre në përpjekjet dhe luftrat e përgjakshme për të garantuar pavarësinë dhe lirinë e dëshiruar. Ndaj, të përulemi me respekt dhe dashuri para veprës dhe kujtimit të tyre!



Fillimi i mirë, gjysma punës

Nga PËLLUMB AGOLLI

Dëgjesë publike

Mbi shfrytëzimin e hekur-nikelit
dhe nikel-silikatit në Bitinckën
perëndimore, Kokogllavë dhe Stranë.

KRYESIA E SHOQATËS "DEVOLLI", DEGA KORÇË, BËRI ANALIZËN E PUNËS PËR VITIN 2015

RIZA ASHIMI,
Sekretar i degës së Korçës

Devollinjtë së bashku në DITËN E FLAMURIT

Nga KOZETA ZYLO, SHBA

INTERVISTË MALLI

Edhe dhimbjet

**nganjëherë i duam, pasi
janë pjesë e jetës sonë**

Nga FUAT MEMELI

**“DHËMBKË E MALLI”,
pohim për rininë e përjetshme
të poetit Fatos Hoxha**

FIGURA QË JAPIN KONTRIBUT PËR IMAZHIN E DEVOLLIT

Pëllumb Agollit, dhe Valent Nallbatit,
iu dha titulli "AMBASADOR I PAQES."

ME RASTIN E 90 VJETORIT TE LINDJES

Sa na ka marrë malli, Ali Kondi...

Nga AGRON SEJAMINI

Ali Kondi ishte shëmbëlltyra ideale e të komunikuarit, modestisë dhe mënçurisë. Ai na fali shumë dashuri, respekt dhe ëmbëlsi... Nëse gjatë bashkëjetesës me të, nuk mundëm t'ia kthenim në të njëjtën masë këto mirësi, të paktën në vijimësinë e jetës sonë t'i ngajmë atij. Kështu jo vetëm do shlyenim një borxh, por do lumturonim edhe shpirtin e tij të ndritur që tashmë prehet në qetësi...

**VEPRIMTARI FESTIVE e Kryesisë së
degës së Shoqatës A.K "Devolli" në Tiranë**



Devollinjtë së bashku në DITËN E FLAMURIT

Nga KOZETA ZYLO

Nju Jorku ndriti dhe më shumë në disa lagje si në Staten Island, Brooklyn etj, nga ngjyrat e Flamurit kuq e zi që valëviteshin në disa rrugë të saj si për festë.

Shqiptarëve në Amerikë iu afrua dhe më shumë Atdheu i tyre, Atdheun që e kanë mal malli në zemrën e zhuritur nga largimi. Kjo bukuri kuq e zi i magjeps shqiptarët, po më shumë në Ditën e shenjtë të Flamurit. Aq i magjeps sa një miku ynë shqiptar na tha se kur po voziste me makinë në Staten Island dhe befas pa Flamujt kuq e zi që valëviteshin krahas flamurit amerikan në Hylan Bulevard, nga emocioni që e kaploi, pa kuptuar kaloi me drita të kuqe...

Në Brooklyn, në një nga qytetet më të populluara të Nju Jorkut, që ka një popullsi rreth 2 milion e 700 mijë gati sa Shqipëria jonë para 20 vjetësh, jetojnë edhe mjaft shqiptarë devollinj. Për çdo 28 Nëntor shoqata "Devolli" feston me madhështi Ditën e Flamurit.

Familjet e bukura devollite vijnë grupe grupe me fëmijët për dore duke mbajtur nga një flamur të vogël shqiptar për të qenë së bashku në këtë ditë të shenjtë. Veshja e tyre kuq e zi i jepte dhe më shumë pamje festive mjedisit ku do të zhvillohej mbrëmja.

Mbrëmjen e ka hapur kryetari i shoqatës së Devollit një aktivist i palodhur me shpirt artisti Odise Salillari, i cili ka uruar gjithë pjesëmarrësit: "Gëzuar Ditën e Flamurit!" duke i ftuar për të kënduar Himnin shqiptar dhe atë amerikan.Ai i falënderoi të gjithë shqiptarët që ishin mbledhur së bashku për të festuar 28 Nëntorin dhe nderoi të gjithë ata burra patriotë që së bashku me plakun e urtë Ismail Bej Vlora ngritën Flamurin në Vlorë dhe shpallën Shqipërinë të pavarur nga perandoria turke e cila na sundoi për 500 vjet.

Në fjalën e tij Salillari ka përshëndetur kryetarin e shoqatës Devolli për Amerikën, Xhevdet Myteberi, ish kryetarin e saj intelektualin dhe aktivistin patriot që ka dhënë një kontribut të çmuar, Neritan Bejleri i cili banon në Kanada, si dhe kryetarin e shoqatës "Devolli" për Tiranën, Guri Seferi. Ndërkohë Salillari përmendi dhe për strukturat dhe përbërjen e shoqatës që janë në Amerikë, New Jersey dhe Connecticut.

Në këtë festë përshëndeti sekretari i përgjithshëm i shoqatës A.K. "Devolli" ish ushtarak në Ministrinë e Mbrotjtjes, Robert Metolli i cili me plot përzemërsi iu uroi të pranishmëve të kalonin një mbrëmje sa më të gëzuar në këtë ditë historike. Një vëmendje të posaçme i kushtoi dhe shkollave shqipe "Alba Life" që fëmijë devollinj shkojnë në shkollë për të mësuar gjuhën shqipe dhe i frymëzoi ata për të vazhduar më tej, po



Mbrëmjen e hapi kryetari i shoqatës së Devollit, Odise Salillari, i cili ka uruar gjithë pjesëmarrësit: "Gëzuar Ditën e Flamurit!" duke i ftuar për të kënduar himnin shqiptar dhe atë amerikan.

ashtu shprehu mirënjohje dhe për TV Alba Life që e ka mbështetur shoqatën "Devolli" me aktivitetet që ka organizuar.

Në shoqatën "Devolli" gjithmonë ndihesh si në shtëpinë tënde ku ata të ftojnë në sofrën bujare të tyre plot mirësi dhe bujari shqiptare. Alegria, këngët dhe vallet karakteristike të rrëmbejnë magjishëm në botën e tyre devolliçe. Tekstet e bukura, lirizmi i ngrohtë, forca patriotike jane metafora e devollit që gurgullon ndër zemra shqiptarësh. Të gjithë burra e gra dorë për dore u ngritën dhe vallëzuan nën argëtimin e muzikantit dhe klarinetistit të talentuar Dashnor Cene, këngëtarit zë ëmbël Edi Duro, luajtur në organo nga Dashnor Hoxha. Por ajo që të bën më shumë përshtypje është se vetë kryetari i shoqatës, Odise Salillari jo vetëm që është një organizator i mirë, por është dhe një këngëtar që tërheq me interpretimin e tij veçanërisht me këngët e trevës devolliçe. Ushtonte

kënga dhe vallja dhe nën ritmin e tyre kërcenin të gjithë, dëgjohej kënga që prek çdo zemër emigranti si:

*Më vjen mall për vendin tim,
Vendin ku linda u rrita,
Më vjen mall për shoqërinë,
Për gurin që lëshon çika.*

Pas një intervali muzikor në skenë është ngjitur dhe miku i shoqatës "Devolli" me origjinë nga Poligani muzikant i vjetër Sefer Hoxha i cili foli me konsideratë të veçantë për devollinjtë dhe iu uroi atyre Festën e Flamurit. Salillari ka ftuar në skenë, Qemal Zylo për të përshëndetur shoqatën "Devolli" i cili pasi iu uroi devollinjve për Ditën e Flamurit midis të tjerash tha se është kënaqësi bashkëpunimi ynë prej vitesh të tëra dhe jam i sigurtë se ky bashkëpunim do të vazhdojë përgjithmonë.

Festën e bënëin dhe më të bukur fëmijët si drita që vallëzonin, qeshnin dhe luanin të gëzuar me njeri-tjetrin. Kush e kush të vinte më parë pranë kamerave dhe të bënte shqiponjën dy krenore me duartë e tyre të vogla dhe të gëzoheshin për këtë ditë të shenjtë.

Prindërit devollinj dinë t'jua transmetojnë dhe t'jua ngjizin në shpirt brezave traditën e mrekullueshme shqiptare dhe njëkohësisht të çojnë më tej traditën, çka të kujton Winston Çurcill i cili ka thënë se: "Pa tradita, arti është një tufë delesh pa bari. Pa risi, arti është një kufomë". Me plot dashuri për traditën, për edukimin e fëmijëve folën nënat simpatike si Mimoza Salillari, Zhuljeta Ktona, Pranvera Kulla, Elida Kaso, etj. të cilat thanë se Flamuri është një nga ditët më të bukura që i mbledh shqiptarët kudo ku janë për ta festuar me madhështi. Jehonin vallet dhe këngët si: Shqipëri o nëna ime, Baba Tomori, Valle e kënduar e Rugovës, Më vjen mall për vendin tim, Vallja e Gajdes, Kajtushka, Çobankat që shkojnë zallit, etj.Sipas traditës së pasur devolliçe mbrëmja u mbyll me vallen e Devollit një valle autoktone shqiptare, një valle e rëndë burrash. Fluturonte shamia e mbajtur nga valltari i apasionuar devolli, Almir Kaso i cili udhëhiqte vallen që e shoqëronin burrat e tjerë kërcimtarë devollinj. Shkrap e shkrup kërcisnin aparatet, filmimi me telefonat dhe të gjithë pjesëmarrësit të ngritur në këmbë shoqëronin valltaret devollinj.

Ç'valle magjepsëse, ç'dashuri ngjall tek të gjithë shqiptarët, ndërsa i shikon se në sytë e tyre ka ardhur si vizitore shkëlqimi i hënës devollite nga qielli i bukur shqiptar për të larguar mallin e emigrantit...

Ishte një natë e bukur devolliçe kuq e zi. Aktiviteti u filmua nga TV Alba Life, dhe do të transmetohet sëshpejti në kanalet televizive.

**28 Nëntor, 2015
Brooklyn, New York**

FIGURA QË JAPIN KONTRIBUT PËR IMAZHIN E DEVOLLIT

Më 27 nëntor 2015, me një organizim të mirë të Forumit Politik të Ballkanit që vepron në suazën e NATO-s, në bashkëpunim me shoqatën "Devolli" dhe me simotrat e saj, shoqatat joqeveritare që veprojnë në Devoll, në kuadrin e festave të mëdha kombëtare, 103-vjetorit të shpalljes së pavarësisë dhe 71-vjetorit të çlirimit, në lokalin "Fati" të qytetit të Bilishtit dy ish-ushtarakëve, Pëllumb Agollit, ish-kuadër ushtarak rezervist, tani mësues në pension dhe Valent Nallbatit, ish-ushtarak aktiv, sot biznesmen dhe drejtor i DSHP Devoll, iu dha titulli "Ambasador i Pages."

Ishin të pranishëm nënprefekti i Devollit Artan Keço, nënkryetari i Bashkisë së Devollit, Ylli Taho, kryetari

Në kuadrin e festave të mëdha kombëtare, të shpalljes së pavarësisë dhe Çlirimit, dy ish-ushtarakëve, Pëllumb Agollit, ish-kuadër ushtarak rezervist, tani mësues në pension dhe Valent Nallbatit, ish-ushtarak aktiv, sot biznesmen dhe drejtor i DSHP Devoll, iu dha titulli "AMBASADOR I PAQES."

i Shoqatës Atdhetare Kulturore "Devolli" Guri Seferi, kryetari i shoqatës së veteranëve të Devollit Bashkim Cane, përfaqësues të komisarariatit të policisë Devoll, ushtarakë në lirim, drejtues të institucioneve vendore, mësues e nxënës.

Ceremoninë e hapi shkrimtari Kosta Nake i cili bëri karakterizimin e të dy personaliteteve sipas njohjes personale dhe pastaj ia dha fjalën Guri Pejo, president i Forumit Politik Ballkanik. Presidenti

bëri një përshkrim të gjatë të kontributit të NATO-s në rrafshin europian dhe ndihmesën e veçantë për Shqipërinë si dhe theksoi ngjarjen e madhe të integritit të forcave tona të armatosura në këtë aleancë të fuqishme ushtarake. Në fund ai vlerësoi punën e madhe që kanë bërë devollinjtë Pëllumb Agolli dhe Valent Nallbati për forcimin e bashkëpunimit mes shoqatave dhe institucioneve shtetërore të Devollit për njohjen e vlerave

atdhetare. Në motivacionin e titullit të Pëllumb Agollit shkruhet: "Personalitet i lartë, mësues me vlera, kontribues në sigurinë, rendin në momente të vështira kritike që kaloi Bilishti, qytetar i nderuar në Qarkun Korçë e më gjerë."

Të dekoruarit shprehën mirënjohjen e tyre për nderimin që iu bë, ndërsa vlerësimet e tyre sollën nënprefekti Artan Keço, kryetari i veteranëve Bashkim Cane, kryetari i shoqatës A.K. "Devolli" Guri Seferi, ish-ushtarakë Robert Remaçka e Nexhat Nallbati.

Me këtë rast dha një koncert të bukur ansambli folklorik i fëmijëve të shoqatës "Devolli" nën drejtimin e koreografit të talentuar, Agron Kordalli.

FEBI KANINA

Fillimi i mirë, gjysma punës

Në qytetin e Bilishtit u zhvillua Konferenca e hapjes për Projektin: **"Forcimi i demokracisë dhe sundimit të ligjit duke forcuar rolin e qytetarëve dhe të shoqërisë civile nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje në qeverisje"**.

Si të gjithë devollinjtë dhe unë kënaqem kur në rrethin tonë vjen ndonjë lajm i mirë ose realizohet ndonjë projekt. Pikërisht kjo ndodhi këto ditë në qytetin e Bilishtit ku u zhvillua Konferenca e hapjes për Projektin: "Forcimi i demokracisë dhe sundimit të ligjit duke forcuar rolin e qytetarëve dhe të shoqërisë civile nëpërmjet proceseve me pjesëmarrje në qeverisje".

Me këtë rast kënaqësia ishte e të gjithëve, jo vetëm se në Devoll po hidhej një hap pozitiv, por dhe për faktin se gjithçka do të bëhej mbështetje nga ambasada e Mbretërisë së Hollandës në Shqipëri dhe që do të zbatohet nga Agjensia Rajonale e Zhvillimit, Korçë, (ARZH).

Në konferencë merrnin pjesë përfaqësues të fermerëve nga fshatrat e gjithë krahinës, këshilltarë të këshillit bashkiak, punonjës të Bashkisë si dhe kryetari i këshillit bashkiak Albert Lilo dhe kryetari i Bashkisë Bledjon Nallbati. Takimin e hapi drejtori i ARZH Aurel Grabocka duke prezantuar projektin me kompetencë profesionale duke vënë theksin në punën që duhet bërë për sundimin e ligjit. Projekti sipas drejtorit do të shtrihet deri në zgjedhjet e vitit 2017. Puna do të kryhet në rrethet Devoll, Korçë dhe Elbasan. Interesant në këtë takim ishte ekspozimi në stenda i problemeve me shkrim që shqetësojnë çdo fshat.

Në fillim u aktivizuan fermerët të thonë mendimin e tyre kur doli se do të funksionojnë 6 grupe pune. Si pjesëmarrës në këtë takim më bëri përshtypje ajo që shprehin fermerët me standartet e merituara ku trajtoheshin problemet që aktualisht shqetësojnë fermerët në çdo fshat të rrethit tonë. Problemet që trajtohen aty ishin të shumta por unë po sjell si shëmbull vetem njërin prej tyre, atë të shitjes së prodhimeve bujqësore që në shumicën e rasteve mbeten pa u shitur dhe pasi kalon koha ato kalben dhe i pranon vetëm lumi i Devollit dhe përrenjtë e

Nga **PËLLUMB AGOLLI**

fshatrave duke marrë me vete koston e prodhimit dhe asnjë fitim. Kjo në Devoll ka ndodhur shpesh, prandaj dhe gjendja ekonomike e fermerëve të krahinës sonë sa vjen e rëndohet. Si një prej devollinjve, mendoj se pushteti vendor dhe aq më shumë qeveria duhet të kthejnë sytë nga Devolli dhe njerëzit e tij të punës sepse mundi i tyre po shkon kot. Pas ekspozimit në stenda folën edhe vet fermerët që synojnë për një jetë më të mirë, por s'kanë asnjë mundësi për përmirësimin e gjëndjes. Me interes u prit nga të gjithë pjesëmarrja e grave dhe e të rinjve në këtë zhvillim, si dhe organizmi i konsulencave për biznesin. Me këtë rast kryetari i këshillit bashkiak Albert Lilo pasi falenderoi drejtuesit e projektit vuri theksin në rritjen e mirqënies së qytetarëve dhe se në funksion të saj do të mirëpritet çdo bashkëpunim.

Kryetari i bashkisë Bledjon Nallbati, pasi falenderoi Mbretërinë e Hollandës tha: "Do të qeverisim mirë kur të kemi bashkëpunime me qytetarët dhe me ARZH". Në përfundim ai theksoi se Devolli ka shumë nevojë për mbështetje. Specialisti i ARZH-së, Gjergji Duro sqaroi se reforma territoriale ishte e vështirë por e domosdoshme dhe suksesi do të jetë i garantuar. Në këtë kuadër theksoi ai bashkia e Devollit duhet të shëndrrohet në forcë lëvizëse zhvillimi duke marrë përgjegjësi mbi vete mbi gjithë funksionarët e bashkisë.

Në këtë kuadër ai tha se kryetarët e fshatrave kanë rol në zhvillimin dhe ecjen përpara të të gjithë punëve që u shërbejnë komunitetit dhe interesave të qytetarëve. Pas kësaj foli Bledar Bezhi si përfaqësues i bashkisë dhe sqaroi se për reformën territoriale ka projekt-ide reale që në të ardhmen do të vihen në jetë. Të pranishmit treguan interes për ato probleme që ngritën përfaqësuesit e fshatrave; Zairi nga

Ponçara vuri theksin me problemin e vaditjes, që direkt ndikon në rritjen e prodhimit, por kjo nuk funksionon sepse nuk bëhet si duhet pastrimi i kanaleve. Shaban Merolli nga Vidohova me shqetësim ngriti problemin e investimeve që në fshatin e tij s'ka asnjë të tillë në një kohë kur ka pika turistike interesante si Shkëmbi i Plakës dhe liqeni përmbi të. Dauti nga Arza tha, se ne kemi forca të bëjmë gjëra të mira, e rëndësishme vazhdoi ai është që zëri ynë të dëgjohet dhe po nuk i rregulluan njerëzit asgjë nuk rregullohet këtu. Ai e kishte fjalën për zbatimin e ligjit i cili sipas tij nuk zbatohet jo vetëm nga të vegjlit, por fillon nga Parlamenti.

Ndryshe nga fshatrat e tjera ne tha ai kemi urgjencë rrugën e cila lidhet edhe me të ardhmen e fshatit tonë sepse ashtu si Dardha fqinje duhet të jetë pikë e rëndësishme turistike. Erlini nga Cangonji ishte me një emërues të përbashkët me të gjithë që folën, por ai ndryshe nga të tjerët tha se ka mundësi që diçka mund të bëjmë edhe vetë dhe solli si shëmbull sistemimin e rrugëve të tokave.

Të tilla probleme me kushte specifike të të gjithë fshatrave nga Rakicka deri në Arzë ngritën edhe diskutantë të tjerë me bindjen se edhe Devolli dhe fshatrat e tij do të meritojnë vëmendjen që deri tani u ka munguar. Sipas këndvështrimit tim të gjithë folën me sinqeritet duke u mbështetur në cilësitë morale që kanë devollinjtë për punën dhe të ardhmen dhe mua në ato çaste mu kujtua një thënie e komediografit Meneandri, që thotë "Vetitë morale të njeriut të drejtë i zëvendësojnë ligjet".

Besoj shumë se devollinjtë përkrah ligjit do të bëjnë më të mirën e fshatrave ku janë dhe të krejt Devollit. Në ato çka u trajtuan në takim nga ARZH-ja me mbështetjen dhe të Mbretërisë së Hollandës kam bindjen se për Devollin është hapur drita jeshile dhe unë shpresoj siç shpresojnë të gjithë se do të bëhet më e mira që meritojmë.

Sigurimi i lejës mjedisore do t'u hapë rrugë hapave të mëtejshëm

Kanë përfunduar punimet e kërkimit në një sipërfaqe prej 3.5 km², është identifikuar një pasuri minerare rreth 39 milion ton që parashikohet të shfrytëzohet për 25 vjet. Parashikohet të punësohen më shumë se 1000 punonjës.

Kompania konsultuese GR Albania Planning & Environmental me porosi të Kompanisë Albanian Nickel Group, e përfaqësuar nga drejtori teknik Panajot Aliçkolli, organizoi një dëgjese publike për ndikimin

mjedisor që do të ketë **shfrytëzimi i hekur-nikelit dhe nikel-silikatit në Bitinckën perëndimore, Kokogllavë dhe Stranë**. Ishte i pranishëm Ylli Taho, nënkryetar i Bashkisë së Devollit, specialistë të



minierave, qytetarë që preken drejtpërdrejtë nga implementimi i projektit të shfrytëzimit. Kanë përfunduar punimet e kërkimit në një sipërfaqe prej 3.5 km², është identifikuar një pasuri minerare rreth 39 milion ton që parashikohet të shfrytëzohet për 25 vjet. Kur shfrytëzimi do të bëhet me kapacitet të plotë, parashikohet që të punësohen më shumë se 1000 punonjës. Në një fazë të mëvonshme parashikohet që pasurimi i mineralit deri në 18% të realizohet në vend duke kufizuar transportin dhe duke rritur fitimin.

Organizimi i kësaj dëgjese është një shenjë e mirë, pasi deri tani ka patur edhe shfrytëzim me karrierë gjë që e ka dëmtuar rëndë mjedisin dhe do të ketë pasoja edhe në shëndetin e banorëve të Devollit. Sigurimi i lejës mjedisore do t'u hapë rrugë hapave të mëtejshëm dhe, nëse gjithçka ecën sipas parashikimit dhe afateve kohore të parapara, puna mund të fillojë nga fundi i pranverës së ardhshme.

Sa na ka marrë malli, Ali Kondi...

As vetë nuk e di sa vjet kemi pa u takuar. Ndoshta pesë, ndoshta dhjetë... Pa u takuar, sepse ëmbëlsinë dhe mënçurinë e fjalës së tij e ndjej në shpirt gati çdo ditë. Është kjo përditshmëri ndjeshmërie që ma ka fshirë nga kujtesa edhe prezencën e tij të fundit në studion time. Të fundit se atë të parën e kujtoj shumë mirë. Ka qenë marsi i vitit 2004...

Sapo hapa derën pas asaj trokitjeje të shkurtër dhe të ndrojtur, menjëherë më buzëqeshi dhe më përqafoi. Për një çast u hutova dhe po ndjehesha në siklet që nuk po i kujtoja emrin. Dialekti edhe më shumë akoma, ma afroi dhe ma bëri sikur të ishte nga Rehova ime... Por, jo! Mu prezantua se ishte nga Vranishti i Devollit dhe dëshironte të realizonte te unë përgatitjen kompjuterike të një libri. Jo një, por tre libra përgatitëm bashkarisht. U bëmë shumë miq me njëri tjetrin por, në asnjë rast ai nuk bëri pazar me korektësinë dhe burrërinë...

Ali Kondi të gjithëve ne, na ka dhënë më shumë se sa e kemi patur hak! Thënë ndryshe, para atij duhet të ndjehemi borxhlinj! Borxhlinj në vlera dhe virtyte që ai i shpalosi denjësisht në çdo hap të jetës. Dhe mendoni, unë që dëshmoj këtë të vërtetë për personalitetin e tij, e kam njohur vonë. Shumë vonë, atëherë, kur ai kishte vite që kishte dalë në pension. Por, e e mjaftueshëm kjo kohë për të mbërritur në një të tillë konkluzion.

Në këtë periudhë si shumica e bashkëmoshatarëve të tij, ai mund të kishte zgjidhur qetësinë dhe kalimin e kohës me të afërmit apo miqtë, të cilët për fat i kishte me shumicë. Mirëpo zemra e tij e madhe vlonte dashuri dhe mirësi. Ndjesi që i ndezën frymëzimin dhe e futën në udhën e vështirë të krijimtarisë... 240 faqe libri shkroi për yjet që ndritën vatanë. Asnjëherë nuk e ka quajtur veten poet Ali Kondi, por shpirti i tij nuk rreshti së krijuari vargje për ata që i dhanë jetën lirisë. Nuk ndali me kaq ky njeri i mirë, por menjëherë ia nisi angazhimit për librin tjetër “Interpretues të këngës dhe valles devollite”.

Dikush në pozitat e Aliut, nëse do i luteshin, ndoshta edhe nuk do e niste atë punë, për arsye të moshës apo sedrës së sëmurë. Aq më tepër, një Artist i Merituar si Ali Kondi që ishte maja e këngës dhe të famshmes “Devolliçe”. Mirëpo... Shpirtbardhësia dhe fisnikëria e tij, ishin në të njëjtat lartësi. Ndaj, shkroi me dashuri për të gjithë ata interpretues që një jetë i kishin mbajtur ison dhe iu bënë pikëmbështetje në fluturimet e tij gjatë kërcimit... Pasi shleu këtë detyrim shpirtëror dhe shoqëror, vetëm atëherë vuri në axhendë të krijimtarisë së tij, librin “Fisi Kondi në atdhetarizëm dhe folklor”.

Ali Kondi ishte shëmbëlltyra ideale e të komunikuarit, modestisë dhe mënçurisë. Ai gjatë jetës së tij na fali shumë dashuri, respekt dhe ëmbëlsi...

Nëse gjatë bashkëjetesës me të, nuk mundëm t’ia kthenim në të njëjtën masë këtë mirësi, të paktën në vijimësinë e jetës sonë t’i ngajjmë atij. Kështu jo vetëm do shlyenim një borxh, por do lumturonim edhe shpirtin e tij të ndritur që tashmë prehet në qetësi...

AGRON SEJAMINI



GJITHMONË I PAHARRUAR!

Aliu, burrë i qeshur me vlera,
fjalë e tij sa shumë ngrohtësi.
I shkëlqenin sytë nëpër biseda,
çdo njeriu i dhuronte dashuri.

Prof. Assoc. Doc. Dr.
ISMET S. LARTI

Aliu, këngëtar i ku do dëgjuar,
zë i rrallë e shumë melodios.
Këngës ja merrte me çdo devolli,
do të ngelet ndër breza një virtuoz.

Aliu, sa i dashur dhe zemërmirë,
ngrohtësinë e shprehte me shpirt.
Çdo bashkëbiseduesi i thurte vargje,
përcillte sinonime të goditura plot dritë.

Aliu, simbol i këngës së bukur devollite,
thurte vargje dhe i këndonte me pathos vetë.
Mjeshtër i madh dhe i valles së bukur devolliçe,
ndaj s’do të harrohet kurrë ky artist në këtë jetë.

Aliu, që kur ishte i ri e deri sa ndërroi jetë,
s’ju mungoj një herë deponimit në festivale.
Me zë bilbili mes duartrokitjesh pushtonte skenat,
adrenalinë shpërndante mjeshtri me këngë e valle.

Aliu, aktivist i pa lodhur i shoqatës Devolli,
vlerë folklori në vendin tonë e festivaleve në botë.
Ky ikonë i devolliut që përcillte kurdoherë urtësinë,
për shumë brezash do të kujtohet si një idhull magjiplotë.

90 VJETORI I LINDJES SË Ali Kondit "Artist i Merituar"

Nga HYSEN KOÇILLARI

Kryesia e degës së Shoqatës AK "Devolli" në Tiranë më 15 nëntor 2015, organizoi një veprimtari homazh me rastin e 90-vjetorit të datëlindjes së Ali Kondit "Artist i Merituar". Miqtë e shokët e tij me pjesëmarijen e të pjesëtarëve të familjes, u mbledhëm e zhvilluan një veprimtari ku folëm plot respekt e kujtuam me nostalgji e vlerësim emrin e veprën e nderuar të devolliut tonë të dashur, njeriut gojëmbël, mbledhësit e interpretuesit të shquar të këngës e valles devolliçe, veprimtarit të përkushtuar e të palodhur të Shoqatës sonë. Ali Kondi u lind 90 vjet më parë, në nëntor të vitit 1925, në fshatin Vranisht të Devollit. Ishte djali i Zyfer Kondit, patriotit e interpretuesit të shquar të këngës e valles devolliçe i cili me punën e tij ia lartësoi më tej emrin fisit Kondi.

Ali Kondi për gati një gjysëm shekulli u dallua për talentin e punën e palodhur si këngëtar e valltar, përfaqësues plot vitalitet e i suksesshëm në grupin artistik të fshatit, përgatitjen e fëmijëve si valltarë të valles devolliçe, pjesëmarrës në festivalet e rrethit të Devollit, Ansamblit të Korçës e në Festivalet Folklorike Kombëtare në Lezhë, Berat e Gjirokastrë ku u laurua me disa çmime. Prej krijimit të Shoqatës A.K. "Devolli" ishte aktiv në veprimtaritë dhe me fjalën e tij dhe këngën e vallen plot ngrohtësi gjallonte mjedisin.

Takimin homazh, nën muzikën e këngëve të interpretuara nga Ali Kondi, e hapi **Anestor Lumi, sekretar i Kryesisë së degës të Shoqatës për Tiranën** i cili tregoi qëllimin e organizimit të veprimtarisë e falënderoi bashkëshorten e Ali Kondit, Mukadesin dhe vajzat e tij, Luljetën, Fitnetin e Mimosën për pjesëmarijen. Anestori, me zë të përmalluar, kërkoi prej të pranishmëve të kalonim një pasdite te këndëshme duke bashkëbiseduar e treguar mbresa, momente kënaqësie e kujtime të bukura e mbresëlënëse gjatë bashkudhëtimit tonë të gjatë shoqëror e familjar me Ali Kondin. Në këtë mjedis të

ngrohtë e mori fjalën **Ziqiri Mançka, Kryetar i Shoqatës A.K. "Devolli, dega Tiranë** i cili në fjalën e tij theksoi:

Me iniciativën dhe dëshirën legjitime të kryesisë së Degës së Shoqatës "Devolli" për Tiranën, jemi mbledhur për të kujtuar, një ndër figurat më të spikatura dhe të shquara të krahinës së Devollit të ndjerin Ali Kondi në 90 vjetorin e lindjes së tij. Artisti i merituar Ali Kondi, lindi në fshatin Vranisht ne një familje me tradita të shkëlqyera, jo vetëm patriotike por dhe folklorike, që më vonë këto do të bëheshin pjesë e pandarë për gati gjysmë shekulli e jetës së tij. Ndonëse ai nuk jeton fizikisht midis nesh, vepra e tij, do të kujtohet dhe nderohet në pafundësi. Emri i Artistit të Merituar është bërë i njohur në traditat tona folklorike, si një ndër valltarët dhe këngëtarët më me zë e më të spikatur në trevat e Devollit. Jeta dhe veprimtaria e tij krijuese e interpretuese mori vrull dhe u ushqye nga traditat e vendlindjes së tij, e në mënyrë të veçantë nga familja Kondi, nga të cilët kanë dalë, këngëtarë dhë valltarë, të cilët i dhanë emër jo vetëm kësaj familje por dhe gjithë krahinës. E ushqyer nga të parët e tij, veprimtaria e Ali Kondit si këngëtar ka filluar që në moshën 12 vjeç. Folklori, këngët dhe vallet u bënë pjesë e pandarë e jetës së tij. E veçantë e tij është se i gjithë thesari i tij është mbledhur dhe gjurmuar ndër vite nga vetë ai. Në visaret e tij të çmuara gjen këngë kushtuar patriotizmit, trimërisë, luftës punës, dashurisë, etj.

Këngët dhe vallet e tij ndër vite janë lanuar që nga radioja lokale e ato kombëtare. Ai ka bërë shumë studime mbi rolin e këngës e të valleve në jetën e Devollit. Për punën e tij të lavdërueshme ai është vlerësuar nga Instituti i Folklorit, duke qenë anëtar i Këshillit Shkencor në vitet 1970.

Për meritat e tij të shquara me dekret të Presidentit më 4 maj 1979, i ishte dhënë titulli "Artist i Merituar", ka qenë anëtar i Unionit Artistik të Kombit shqiptar,

anëtar i klubit "Miqtë e Dritëroit". Ka marrë pjesë në aktivetete të ndryshme ndërkombëtare, si në Festivalin e Moskës, etj. Veç veprimtarisë së tij krijuese ai ka qenë nga të parët themelues të Shoqatës AK "Devolli" dhe një nga aktivistët më të shquar të saj.

Me veprën e tij ai i dha emër, jo vetëm familjes, por edhe gjithë krahinës. Në gjithë veprimtarinë e tij, ai ka patur në krah jo vetëm si bashkëshorte por edhe si bashkëpunëtore të devotçme të folklorit të tij, Mukadesin me zërin e saj që duke iu bashkangjitur bukur zërit të bilbilit Ali Kondit krijuan një dyshe të mrekullueshme.




Ndërkohë **Ismet Larti**, gjallëron mjedisin duke ngritur volumin e muzikës së një valle të kënduar devolliçe. Valltarët formuan vargun e nisën të luajnë. Po cilët janë? Për një pjesë janë të panjohur, janë vëllezërit Driton e Arben e Becolli të cilët i shoqëruan Luljeta, Fitneti e Mimoza, të njohura që në fëmëni e rini si interpretuese të talentuara, ato janë pjesëmarrëse në festivale lokale, rrethi, zonale etj. Luljeta gjatë viteve në veprimtaritë folklorike ka fituar disa çmime. Motrat, veç apo bashkë, kanë interpretuar në fshat, zonën e Devollit, fshatrave të Prespës e Gorës, gjatë ndërtimit të hekurudhës Librazhd-Prenjas, në Helmës të Skraparit, Tiranë etj. Më pas mësova që vëllezërit Becolli ishin kushurinj me familjen Kondi. Beni me krenari e ndjenjë mirënjohje për Aliun më tregoi se të dy vëllezërit kishin qënë valltarë të grupit të të vegjëlve që Aliu formoi e përgati në Vranisht në vitin 1973. Vëllezërit me grupin e të vegjëlve, rrjedhojë e nivelit të lartë të interpretimit, u bënë përfaqësues të interpretimit të valles devolliçe në fshat, krahinë, rreth e nivel kombëtar.

Vallet pasonin njëra-tjetrën, të pranishmëve iu zgjuan kujtimet e u bënë më të ndjeshëm. I pari e mori fjalën **Myfit Lulo**, ndër më të moshuarit e pranishëm, i cili, duke iu drejtuar Mukadesit, bashkëshortes së Aliut, tha se njohja e tij me familjen Kondi ishte familjare dhe e hershme, që në rininë e tyre. Më pas, theksoi që në punën e suksesshme të Aliut-artist, rol pozitiv ka luajtur edhe Mukadesi jo vetëm si gruaja e tij po dhe si shoqëruese në dhjetra këngë që interpretuan për dekada të tëra. Në vijim, me kënaqësi u dëgjua fjala e **Irfan Lulos, ish kryetar i Shoqatës** për një kohë të gjatë. Ai përcolli mbresa e episode të këndëshme nga njohja e gjatë me Aliun e shfaqti mendimin që Shoqata t'i propozojë pleqësisë së Vranishtit të miratojë vendosjen e bustit të tij në qendër të fshatit si vlerësim për punën që ka bërë për fshatin dhe Devollin.

Në këtë atmosferë argëtuese e mori fjalën **Guri Seferi, Kryetar i Shoqatës AK "Devolli"**, i cili vlerësoi nismën e Kryesisë së Tiranës për organizimin e veprimtarisë, shprehu mirënjohje për Ali Kondin, një nga devollijtë që ia lartësojnë emrin vendlindjes dhe premtoi që aktivitete për të respektuar emrin e punën e devollijve në fusha të ndryshme të jetës do të organizojnë dhe degët e rretheve. Nuk kanë të lodhur vajzat e Aliut, bëhen nisiatore të kërcimit të shumë valleve, shpejt vargu bëhet i gjatë e shpirti artdashës i devollinjve shpërthen me tërë vitalitetin e tij karakteristik.

Akoma pa u ulur mirë kërcimtarët, filloi të flasë **Agim Koçillari**, një nga nismëtarët e formimit të Shoqatës. Ai e vlerësoi Aliun si një nga veprimtarët më të dalluar këngëtarë që ka bërë e la emër në Devoll e më gjerë. Bashkëbiseduesi propozoi që të ndërmerret nisiativa të hulumtohet e mblidhen këngët popullore më të bukura të Devollit dhe me to të përgatiten disqe për simpatizantët. Fjalët dashamirëse për Ali Kondin në këtë veprimtari nuk kanë të mbaruar. Vasil Fundo, sekretar i Shoqatës AK "Devolli" e vlerësoi Aliun si njeri të dashur, gojëëmbël e shembull komunikimi me këdo, të rinj e të reja, devollij e dashamirës të Shoqatës, prandaj për këdo që e ka njohur, vuri në dukje folësi, ai do të mbetet model veprimtari.

Më pas e mori fjalën **Hysen Koçillari** i cili duke iu drejtuar pjesëtarëve të familjes, përmendi disa cilësi pozitive nga puna gjysëm shekullore e Aliut-artist. Ai vuri në dukje se Ali Kondi me punën e palodhur që bëri, marrëdhëniet e mira që ndërtonte dhe librat që shkroi, përjetësoi fisin e familjen Kondi, tregoi që ishte



O kjo anë e lumit
Ka bilbila shumë,
Dale bandill, dale
Sa të rritem më.

Një ndër këta bilbilë të
anës së lumit, që quhet Devoll,
është Ali Kondi. Dhe do të
thosha bilbil mbi bilbilët,
që ia zbuloi më mirë nga të
gjithë bukuritë këngës de-
volliçe.

Dritëro Agolli

pinjoll vazhdues i traditës familjare në fushën e folklorit. Larmia e niveli i punës që kreu Aliu në fushën e folklorit e bëjnë një nga emrat e nderuar që do të mbetet në historinë e kulturës popullore të Devollit. Hyseni e përfundoi fjalën duke ngritur një dolli me shëndete për kujtimin e emrit të Aliut, pjesëtarve të familjes dhe të pranishmit në sallë. Ismeti kishte zgjedhur një mënyrë interesante për t'u shprehur, lexoi një poezi kushtuar me këtë rast Ali Kondit. Pjesëmarrësit në veprimtarinë homazh, në emër të familjes së Ali Kondit i përshëndeti **bashkëshortja e tij, Mukadesi** e cila falenderoi Kryesinë e Shoqatës për respektin që tregon për kujtimin e bashkëshortit të saj. Ajo tregoi momente të bukura nga jeta që kur krijoi familjen me Aliun me të cilin mori pjesë në çdo aktivitet folklorik në fshat, lokalitet, zone, rreth dhe në disa Festivale Folklorike Kombëtare.

Devollijtë e pranishëm, për kënaqësi të ndërsjelltë, filluan të ngriheshin nga vendet ku ishin ulur dhe me gotë në dorë lëviznin e bisedonin me familjarët e Aliut e të tjerë në sallë, kështu bashkëbisedimi u bë më i ngrohtë. Këtë situatë shfrytëzuan vajzat e Aliut të cilat ia nisën këngës "Kur rashë ne burgun e Korçës". Pjesëmarrësit në sallë i përshëndeti dhe **Ervehe Baruti, Kryeredaktore e gazetës “Devolli”, Punonjëse e Vjetër Shkencore në Institutin e Kulturës Popullore** e cila për dekada ka qenë e afërt e bashkudhëtare në veprimtarinë e Aliut-artist. Ndër të tjera ajo veçoi, se “veçanërisht në familjen e Ali Kondit janë trashëguar brez pas brezi ca gene fatlume që e bëjnë çdo të porsalindur rob të ardhshëm të këngës dhe valles. Them rob sepse nuk ka Zot që ta ndajë nga

zëri i të parëve, s'ka forcë që ta shkëputë nga ky amanet i fshehtë që e detyron njeriun që të këndojë dhe të vallëzojë gjithë jetën. Ali Kondi ka qenë dhe mbetet një bartës i shquar, jo vetëm në njohjen e folklorit të Devollit, por edhe si një interpretues virtuoz i valles devolliçe. Nuk është e rastit që individualiteti i tij është manifestuar deri në pjesëmarrjen e festivaleve folklorike në rrethet Korçë, Devoll, Tiranë dhe qytete të tjera si dhe ai në Festivalin e Moskës. Por, veçanërisht në festivalet e madhërishëm të zhvilluar në qytetin e Gjirokastrës. Jam dëshmitare e lojës mahnitëse të Ali Kondit në këngët dhe vallet e interpretuara, çka janë vlerësuar nga shikuesit dhe specialistët. Veprimtaria krijuese dhe interpretuese e Ali Kondit është vlerësuar edhe nga studiuesit e Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë. Unë e kam ndjerë veten të privilegjuar që kam patur bashkëpunim të vazhdueshëm me Ali Kondin sepse kam njohur një njeri, në kuptimin e plotë të kësaj fjale. Ndaj unë e kam falenderuar me mirënjohje dhe nderim të singertë. Ali Kondi nuk është mes nesh, por mbetet simbol i një talenti të rrallë, i një njeriu të urtë i mbushur plot mirësi dhe zemërbardhësi”.

Devollinjtë artdashës e punëtorë shoqëruar nga të papërtuarit, Arbeni, Dritoni, vajzat Kondi, pa e ndjerë lodhjen heqin përsëri valle. Aparatet fotografikë e celularët e shtojnë punën e shkrepën dhjetra herë për foto dyshe, grupe të vegjël apo bashkë me pjesëtarët e familjes dhe disa herë për pjesëmarrësit në veprimtari. Kështu nisi e u zhvillua për disa orë, në një mjedis të ngrohtë bashkëbisedimi, ky aktivitet homazh me rastin e 90 vjetorit të lindjes së Ali Kondit "Artist i Merituar".

FALENDEROJMË Sponsorizuesit e këtij aktiviteti:
MYFIT LULO, DEMIR AGASTRA, SPARTAK MERAKU, ENGJËLLUSH JAZXHI,
duke ju uruar shëndet, mbarësi në familje dhe suksese në bizneset e tyre.

“Dhëmbkë e mall”, pohim për rininë e përjetshme të poetit

Vëllimi i Fatos Hoxhës ka karakter mozaikal. Aty përfshihen poezi, ese, rrëfime, analiza veprash dhe kujtime. Në vjershat e tij që kanë karakter lirik më të realizuarat janë ato me frymë popullore, disa prej të cilave çuditërisht ndërthuren me ndikim nga folklori, një frymë e lehtë lasgushiane, pra ndikohet nga një poet thellësisht elitar si Lasgushi. Vjershat e Fatos Hoxhës kanë tematikë të shumëllojshme, lirikë erotike, ese, kujtime familjare që i kushtohen vëllait të autorit i cili përjetoi dramën e humbjes së shikimit dhe mbesa e cila i frymëzon autorit dashuri dhe mirësi.

Dashuria mbështjell tërë lirishtat e Fatosit, qoftë dashuria për vajzën, qoftë dashuria për të afërmit apo miqtë, qoftë për natyrën që është për të strehë paqeje dhe mishërimi i bukurisë. Mund të citojmë lirika si: “Ç’po ndodh?”, “Seç po fryn një erë”, “Portret”. Atje ku pleqëria kthehet në magji, “Nova nëpër këngë”, “Nova jonë dashuri”...

Tipari më i goditur i këtyre vjershave është çiltërsia e ngrohtë njerëzore. Edhe figuracioni është i freskët dhe befasues:

*Nga qepallat pikon
vesë dashurie,
mjaltë dhëndërie,
këngë nusërie.*

Një metaforë e goditur dhe e pazakonshme është edhe ajo që gjejnë të njëjtën vjershë:


*Ç’më ke lyer qerpikun,
me të verdhën e hënës.*

Poeti parapëlqen strofën katërshe, por pëlqen edhe treshen lasgushiane, si në vjershën “Dale moj” që e rikrijon modelin lasgushian po në një mënyre të re të veçantë që e ka origjinalitetin e vet.

Fatos Hoxha zgjedh me kujdes edhe epitetet kompozite: qepallë - gjelbër, (Një natë). Valë, përvëluar (Unë nuk vdes). Vjershat e Fatosit përshkruhen nga malli, një mall i ëmbël si prushi, një mall për rininë që ikën. Një pohim për rininë e përjetshme të zemrës së poetit. Edhe analizat e veprave, të dhëna në formë impresioniste, kanë veçorinë e tyre. Mund të përmendim vëzhgimet letrare për “Shoku Zylo”, të D. Agollit, për “Darkën e gabuar” të Kadaresë, për “Zonjën Bavari” të Floberit, ku autori përpigjet të japë një mendim të vetin mbi vepra për të cilat është shkruar shumë po që, si tërë veprat e shkruara, janë të pashtershme. Fatos Hoxha shkruan me thjeshtësi e me qartësi. Si ka thënë dikur një poet “Gota e tij është e madhe, po ai pi nga gota e vet”. Fatos Hoxha me këtë vepër lartëson vlerat në historinë e letërsisë të dheut të Devollit dhe në letërsinë shqiptare.

Ndaj e falenderojmë autorin për “Dhëmbkë e Mall” dhe i urojmë krijimtari të mbarë.

ERVEHE BARUTI



Veprimtari e shoqatës A.K. "Devolli", dega e Tiranës, në prag të festave të Nëntorit

Promovohet libri i Fatos Hoxhës "DHEMKË E MALL"

Më 29 Nëntor 2015, u zhvillua promovimi i librit më të ri të Fatos HOXHËS "Dhemkë e mall" ku merrnin pjesë anëtare të shoqatës "Devolli" dega e Tiranës, poetë devollinj si Demir Gjergji, Liza Lazaj, Eli Kanina dhe deri te më i riu, student i degës së gazetarisë dhe nje poet në premtim kohor, Andrea Danglli, studiuesja dhe kryeredaktorja e gazetës "Devolli", Ervehe Baruti, etj. Takimin e zbukuroi dhe pjesëmarrja e poetit vlonjat Idajet Jahaj, i cili është dhe redaktori i librit, si dhe e poetit mirditor Viktor Gjikota dhe studiuesi e botuesi Mark Simoni. Në promovim ishte dhe kryetari i shoqatës "Devolli" A.K. Guri Seferi.

Takimin e hapi autori i librit Fatos Hoxha, i cili, pasi përshëndeti të pranishmit, bëri një ekspozë të vetë librit. Ai nënvizoi se libri në vetvete është një dhemkë malli për vendlindjen, për të afërmit atje në Devoll, në fshatin Menkulas, për fëshfërimën e gjetheve, për erën që fryn nga Morava, për gurgullimën e ujit të Devollit që zbret nga Nikolica e nga Vala, për gjethet që zbresin nga Poçrova dhe marrin tatëpjetën e lumit duke kapërcyer Cangonjin.

Poeti dhe studiuesi Sali Zaimi, ndër të tjera theksoi se: Portreti i Fatosit vjen dhe gdhendet natyrshëm nga njëri libër tek tjetri. Te libri "Përtej mjegullës" nëpërmjet poezive dhe tregimeve fillon të krijohet baza e një "orteku" letrar i cili përmbushet me novelën " E shkuara drithëruese" që merr skalitjen tek libri që kemi në dorë "Dhemkë e mall"

Lirikat rrjedhin nga një burim frymëzimi që ndërthurin ndjenjat mes dashurisë, mallit dhe dhimbjes.

Dashuria, malli dhe dhembja ndërsillen ngadalë - ngadalë, të rrëmbejnë, të sjellin në ëndrrat e dikurshme si degëzat e përrënjeve që bashkohen e formojnë një "lumë" poezish plot muzikalitet, që përcjellin tek ne mesazhet e jetës përmes lirikave të gëzimit e të hareshmes, të frymëzuara në çast. Lirikat e mallit për vendlindjen janë estetiksht të pjekura për prindërit dhe njerëzit e tij të afërt, të njohur dhe bashdhetarë në hapat e jetës së poetit. Në të gjithë librin autori del një liriko - romantik sfidues me frikën duke kapërxyer me gjykimin narcistik nëpërmjet ritmit të zemrës së tij që e rrukullis rrugëve të viteve të jetës, të ngjarjeve dhe befasive. Si krijues i poezisë lirike të dashurisë, ai vjen dhe i vërtetë, konkret dhe ideal, ashtu si e kishte ëndërruar.

*Luan me këngën, luan me erën
Gjithë prush e afsh
Nuk ia di ti djalit brengën
Gjithë dhemkë e mall.*

Përjetësinë autori e kërkon si një triumf simfonik nëpërmjet këngës. Po këngët që ka shkruar janë plot optimizëm dhe përcjellin te lexuesi nëpërmjet fjalës poetike me ngarkesë shumëngjyrshë që e ngacmojnë ndjenjën dhe ëndrrën. Por poeti nuk është vetëm i ndjenjës së butë e përkëdhelëse, por është dhe i shpërthimeve. E kush e ka njohur nga afër Fatosin dhe nuk ka si të mos i kuptojë vargjet e mëposhtme:

*Dal në kreshtat e Moravës/ dhe bërtas sa kam fuqi/
Heu dashuri! Zogu I verës? / Do të të uth ty përsëri!*

Dhe kështu Fatosi merr fuqi poetike "Çmendurisht e çmendurisht" dhe nuk rri pa i sjellë vitet e rinisë së kahershme, adolehencën gjimnaziste, romantizmin dhe liberalizmin e bukur shkodran, kohën e punës në shumë treva të Shqipërisë, njerëzit që ka njohur të cilët i ka përjetuar në vargjet e poezive të tij

Ndërsa poeti Idajet Jahaj solli në fjalën e tij interpretimin e titullit të librit "Dhemkë e mall". Ky titull,-

theksoi ai, - ka brenda atë zjarrin e madh të njeriut - mallin e pushuar për shokët e miqtë e shumë dekadave, që nga vitet '70-të të shek të kaluar e deri sot.

Pra, malli flakëron në kujtime, nëpër fjalë e vargje, si dritë smeraldi. Kjo është e natyrshme, për çdo njeri, për secilin nga ne. Por te fjala "dhemkë" ka një bukuri tjetër. Fatosi përdor prapashtesën "kë"- dhemkë. Pra e zvogëlon, por ajo njëkohësisht është edhe zbutëse e përkëdhelëse e fjalës "dhembje"ose "dhimbje". Kjo prapashtesë zonale i jep fjalëzës një bukuri të ëmbël. Ajo duket zvogëluese, por fokuson një përmbajtje shumë të madhe. Ajo shpreh në mënyrë të koncentruar reagimin shpirtëror ndaj mallit. Pra është dhembje, - pra dhemkë. Si një relike e çmuar, fjala "dhemkë" shpreh dertin e ndarjes nëpër dekada nga shokët e shoqet, nga miqtë e shumë. Sjell trishtimin e natyrshëm nga ndarja e largësisë, por është dhe e ndritshme, pra "trishtim i ndritshëm", sepse ruan relikat e kujtimeve, të mbresave, të rezatimeve shpirtërore...

Ndërsa poetja Eli Kanina, theksoi në diskutimin e saj se: Ky është libri i ri i Fatos Hoxhës, që në ditën e çlirimit, na çliroi nga angazhimi familjar për të qënë pjesë e tryezës së familjarëve dhe miqve të tij devollinj dhe jo vetëm, mes vargjeve dhe muzikës... Edhe pse është një libër me dedikim për dy familjarët e tij të shtrenjtë, ai mund të lexohet po aq ngrohtësisht nga gjithkush që e merr në dorë. Ky libër është një miksim gjinish letrare që nga poezia, rrëfimi, eseja letrare, recensionet letrare, letërkëmbimet me miqtë dhe foto shoqëruese. Impresionimi im gjatë leximit të librit ka qënë në tre këndvështrime:

- 1- Si bijë e një devolliu, kam gjetur aty shprehje tipike të asaj zone, të cilat më kanë rritur duke u përdorur nga im atë. Tipike është prapashtesa - kë, që duket se zvogëlon, por realisht e thekson më tepër fjalën
- 2- Si femër, jam joshur nga vargjet ala lasgushiane, por me ndjesi origjinale të Fatosit, që herë si gaz e herë si brengë, i gëzohet gjithsesi e i këndon me vargjet e tij bukurisë e mengurisë së saj.
- 3- Si krijuese, kam lexuar librin, jo me xhelozinë e një autori tjetër konkurent në treg, por me dëshirën për të njohur letërsinë bashkëkohore dhe për të gjetur detaje që shprehin individualizmin e penës së tij. Duke lexuar recensionet e tij për librat e D. Agollit, I. Kadaresë, P. Markos, E.Koliqit etj, kam mësuar letërsinë brilante që e ka ushqyer këtë autor, por edhe kulturën letrare me të cilën ai i analizon.

Së fundi, duke marrë shkas nga vargjet e poezisë së tij "Atje ku pleqëria kthehet në magji", por edhe si mjeke, i them autorit se pleqëria nuk vjen me numra vitesh, por me shpirtin, kur ai rrudhet e shterr. Te ty Fatos Hoxha është shumë e largët pleqëria, sepse shpirti yt ka akoma dhemka e malle për të shtrydhur e pikuar, që presin të shkruhen në libra të tjerë. Pranë bashkëshortes Bajames, kaçurelave si ëngjëll të mbesës Novë, por dhe familjarëve dhe miqve që janë burim kënge (ashtu si në këtë festë) dhe motiv jete per ty.

Një diskutim me profesionalizëm, duke vënë në dukje gjuhën artistike, figuracionin elokuent e të ndezur të poezive, lirikën e rrëfimeve në prozat poetike, gjuhën e pasur e krijuese në neologjizma, të veshura me një sintaksë për t'u patur zili, bëri dhe poeti Demir Gjergji.

Diskutuan edhe Mark Simini, Ideal Kadia, Gëzim Begolli Nafiz Topi e tjere, si dhe kryetari i shoqatës Guri Seferi. Takimi kaloi në një atmosferë festive.

SHPËTIM DAJAKU

Intervistë
malli e bashkë-
atdhetarëve
tanë

Bisedë me poetin nga Arza, Riko Hanelli Edhe dhimbjet nganjëherë i duam, pasi janë pjesë e jetës sonë



Kam lexuar mjaft poezi të tua dhe tek ato ve re dy motive kryesore: vendlindjen e dashurinë. Pse kaq shumë i lidhur pas tyre? Le ta fillojmë me vendlindjen.

Temat që kam lëvruar unë, janë ato që i kam prekur, që i kam jetuar. Unë shkruaj për ato tema që kanë lënë brazda në jetën time. Mundohem t'i mbush ato brazda, por ato vijnë e thellohen më shumë. Nuk mund t'i shmangem atyre kujtimeve dhe ulem e shkruaj. Asnjëherë nuk mund ta harroj të kaluarën. Nuk jam as shkrimtar, as poet. Shkruaj për ato që ndiej.

Po ndalem tani te tema e vendlindjes, të cilën siç thoni ju e kam trajtuar disa herë. Në vendlindje, ne u rritëm, aty hodhëm rrënjë. Të mohosh vendlindjen nga ke ardhur, do të thotë të tharesh si ai kërcuri. Po harrove vendlindjen, ti vetë i pret rrënjët asaj. Kur kthen kokën mbrapa, shikon të kaluarën, shikon vendin ku je rrezuar, ku ke qarë, pasi jeta i ka të gjitha. Edhe dhimbjet nganjëherë i duam, pasi janë pjesë e jetës sonë. Aty kemi qarë kur na ka vdekur njeri, kur jemi ndarë, kur na kanë bërë një padrejtësi. Kemi qarë edhe kur na kanë lindur fëmijët, pasi njeriu qan edhe nga gëzimet. Të harrosh vendlindjen, do të thotë të mohosh veten. Mua më vjen keq kur dikush këtu në Greqi, mohon fshatin, i vjen turp ta përmendë. Përkundrazi, unë gjithë miqve u them që jam nga Arza, i them që jam djali i Mynyrit dhe i Delinës. Do ishte qesharake të veproja ndryshe. Do ishte njëlloj sikur të vinja një maskë.

Besoj se "magneti" i vendlindjes të tërheq dhe, megjithëse je larg, shkon aty herë pas here.

Vërtet e kam larg Arzën por shkoj disa herë aty gjatë vitit. Unë shkoj aty për t'u shlodhur, paqka se rruga është e keqe dhe gjithë baltë, paqka se nuk janë ata njerëz që kam lënë. Disa prej tyre janë bërë edhe njerëz të cmirës, ndërsa unë nuk ndryshoj. Dua të jem ai që kam qënë. Disa prej tyre kanë marrë 5 lek dhe i duket sikur kanë zënë Perëndinë me dorë. Kur largohem nga Arza dhe mbyll portën e shtëpisë, më duket sikur kam lënë dikë jetim. Kur shkoj aty, edhe një qen sikur të gjej pranë shtëpisë, më duket sikur ajo jeton, sikur buzëqesh.

Me që jemi te vendlindja, mund të na thuash ndonjë poezi që i ke kushtuar asaj?

Poezitë për vendlindjen, janë të shumta. Po përmend njëren prej tyre, e cila titullohet: "Arzës":

*Sa here që jam pranë teje
Vij me qejf dhe ik pa mend
Unë vij të shuaj mallin
Ti më mbush me mallin tend.*

Në një poezi kushtuar vendlindjes, ndër të tjera, them se nuk shkoj aty për të ngrënë, por sepse...

*Diku më ka mbetur një fjalë pa thënë
Dikujt i kam borxh një "natën e mirë..."*

Në poezitë e tua, i këndohet shpesh baltës. Kaq e dashur është ajo për ty?

Po, toka, balta, janë shumë të dashura për mua. Mbi këtë baltë, kemi shkelur, kemi rënë, jemi ngritur dhe do s'do, ajo është brenda jetës sonë. Ajo baltë na ka ushqyer. Këtë baltë, unë e kam të dashur, e kam timen, megjithëse e ka emrin "baltë". Por, baltë, nuk do të thotë urrejtje, nuk do të thotë injorim. Do ishte qesharake që dikush të fliste keq për baltën. Unë baltën e dua. Edhe kur isha fëmijë, lodrat e para ishin prej balte. Kjo baltë, nuk na ka rritur vetëm ne por ka rritur

nënën e babanë, gjyshrit e gjyshet, ka rritur breza të tërë. Ajo do rritë edhe mijra breza të tjerë, kështu që ju lutem, mos flisni keq për baltën.

Le të ndalemi pak tek tema e dashurisë, të cilës ti i je referuar jo pak herë në poezitë e tua.

Unë nuk kam qënë ndonjë Don Zhuan, megjithëse të dashurosh me gjithë shpirt, nuk është ndonjë gjë e keqe. Një njeri që nuk ka dashuruar, është sikur të mos ketë jetuar. Dashuria i plotëson ndjenjat e njeriut. Një njeri i dashuruar, është më i ndjeshëm. Ai mund të grindet më pak e mund të falë më shumë. Nëqoftëse një njeri është i nxehur dhe i del përpara e dashura, ai zbutet, sikur i ke hedhur ujë të ftohtë. Është ndjenja e bukur e dashurisë, që e ka këtë fuqi magjike. Diku kam lexuar se nuk mund të flasë për dashurinë, ai që nuk e ka provuar, pasi fjalët e tij do të jenë artificiale.Unë dashurisë i kam marrë esencën. Mund të kem qënë edhe vetë viktimat.Të dy viktimat, bëjnë dhimbje, kanë sjellë shqetësim edhe tek të tjerët. Këto ngjarje, duhet t'ia përcillen njerëzve në mënyre artistike. Duhet ta prekësh tjetrin. Ky është arti. Gjërat e bukura, mbeten.

Me që jemi tek poezitë me temë

dashurie. Na i ilustru me ndonjë prej tyre.

Me gjithë qejf. Po të recitoj një nga ato. Titullohet: "Përballë pasqyrës".

*Një plagë e mbetur prej kohësh në zemër
Një thinjë e një rrudhë më kanë pushtuar
Më flasin nga larg me zë dhe me emër
Nga dora jote më janë dhuruar.*

Ndonjë temë tjetër që të ka tërhequr në poezitë e tua.

Një ditë shkrojta një poezi për një fëmijë, i cili po qante pasi po i ndaheshin prindërit. E pashë nga ballkoni këtë skenë dhe s'mund të rija indiferent. Kjo ngjarje mund t'i ndodhte një njeriut apo mikut tim. Loti i asaj fëmije, më plagosi jo vetëm mua, por edhe të tjerë, pasi është lot i viktimës së pafajëshme. Unë shkruaj për ato që ndiej. Jam aty brenda, jam nëpër shkronja, nëpër vargje dhe notoj në atë varkë.

Çfarë të dhimbset më shumë ty? Kush ta thyen zemrën?

Tre lot mund ta thyejnë zemrën time: loti i fëmijës së braktisur, loti i femrës së tradhëtuar dhe loti i plakut të flakur në rrugë.

A ka ndërmend Rikua të kthehet të jetojë në vendlindje?

Kur ika nga Arza, lashë dashurinë aty, lashë brengat, dhimbjet e shpresat. Duke ikur, njeriut i mbetet koka mbrapa, me dëshirën që të kthehet prap aty. Kur ika nga Arza, shpesh më shkonte mëndja për t'u kthyer atje. Dhe përsëri më shkon. Tani kurizi më është bërë sikur më ka zënë samari, sikur ma kanë hequr stelën dhe kashtën.

Kjo jetë kaq vite jashtë, ka lënë gjurmë tek mua. Më dhembin këto plagë ditën dhe i lutem natës të m'i shërojë. E, megjithatë të nesërmen kam të njëjtën dhimbje. Shpesh pyes veten: po të kthehem prap në Arzë, mos humbas edhe 20 vjet të tjera? Ndoshta duhen edhe 20 vjet që të përshtatem aty. Në Greqi kam një jetë të dytë por jeta bazë është në Arzë. Sado jetë të mirë të bëj unë këtu, sado lek apo makina lluksoze të kem, këto për mua mbeten sekondare. Në fund të jetës do mbeten ato dy metra vend. Dhe unë them: m'i mbani ato dy metra vend aty në Arzë.

Bisedoi:
FUAT MEMELLI

KRYESIA E SHOQATËS A.K. "DEVOLLI", DEGA KORÇË, BËRI ANALIZËN E PUNËS PËR VITIN 2015

Më datë 27.11.2015 në një nga sallat e Bibliotekës "Thimi Mitko" në Korçë, kryesia e shoqatës A.K. "Devolli" dega Korçë bëri analizën e punës për vitin 2015 dhe miratoi projektin, detyrat për vitin 2016. Materialin analizë e mbajti kryetari i kësaj dege, Nexhat Nallbati.

Në përgjithësi detyrat e këtij viti u realizuan dhe mbi këto arritje mendohet të projektohen detyrat e vitit 2016. Mbas diskutimeve të anëtarëve të kësaj kryesie, u miratua projekt detyrat për vitin 2016.

1. Të vazhdohet anëtarësia në shoqatë në të gjithë qytetin e Korçës, sidomos në Universitet.

2. Të vazhdojë dhe në vitin 2016

abonimi në gazetë duke rritur numrin e abonimit.

3. Të rritet bashkëpunimi me shoqatat simotrat në të gjitha fushat.

4. Të furnizohet gazeta me informacione nga kjo degë.

5. Në 3 mujorin e katërt të ketë aktivitete kushtuar 20-vjetorit të formimit të shoqatës A.K. "Devolli".

Në këtë aktivitet merrte pjesë dhe kryetari i shoqatës kombëtare Guri Seferi i cili përshëndeti këtë Kryesi në emër të kryesisë kombëtare dhe uroi që dhe në të ardhmen kjo degë të jetë një nga degët shembullore në shtrirjen e saj.

RIZA ASHIMI,
Sekretar i degës së Korçës

